

VENDIM
Nr.84, datë 11.12.2008

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT NGA BANKAT TË REZERVËS SË DETYRUAR
NË LEKË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19, nenit 20, nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, pika 2 të rregullores “Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”, miratuar me vendimin nr.43, datë 16.7.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të lejojë bankat dhe degët e bankave të huaja të përdorin çdo ditë, deri në 40 (dyzet) për qind të shumës së rezervës së detyruar në lekë.
2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin menjëherë të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi nr.44, datë 16.7.2008 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e përdorimit nga bankat të rezervës së detyruar në lekë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 24.1.2009.

KRYETAR
Ardian Fullani